Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m²)
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Arat/Njive/Arable	Arë E Klasës 2/Njiva 2 Klase/2nd Class Arable Land	5272



B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pëshkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Qiranbajtje 99 vite / Pod Zakupninom 99 godine / Leasehold 99 years	"Hib Petrol" Sh.p.k	70249534	FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ /		MAGJ. FERIZAJ - PRISHTINË	1/1	346/2019	16.04.2019

C. HIPOTEKA - HIPOTEKA - MORTGAGE

C.1. Informata për hipotekën - Informacija o hipoteci - Mortgage information

Shuma e borxhit Iznos duga Amount of debt	Shuma e borxhit me shkrim Iznos duga slovima Amount debt in writing	Data e kthimit Datum isteka Due date	Prioriteti Prioritet Priority	Afati dhe kushtet Rokovi i uslovi Terms and conditions	Pëshkrim Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
6250000 EUR	Gjashëm1millionDyQindPesëdhjetëMijë	01.03.2033	3	Limiti I mundësuar deri ne 6,250.000,00 Euro me maturitet prej 10 vitesh me kamate vjetore maksimale 12% se bashku me te gjithe kamaten, shpenzimet, pretendimet mbi komisionet gjë që i nenshtrohet . Marveshjen kryesore e mundësuar me nr 96230 te dates 13/04/2023 dhe kontraten mbi hipoteken LRP. Nr. 6030/2023, Nr.ref 2134/2023 te dates 05/05/2023 te pepluar dhe vertenar nga Noteri Ylli S. Mekaj.	KolateralID: K70804 dt.18.05.2023	24.05.2023

C.2 Komponentët e hipotekës - Komponente hipoteke - Mortgage components


Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Residence	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pëshkrim Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
PENGDHËNËSI / Duznik- Hipotekami / MORTGAGOR	"Hib Petrol" Sh.p.k	70249534	FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ /		MAGJ. FERIZAJ - PRISHTINË	KolateralID: K70804 dt.18.05.2023	24.05.2023
PENGMARRËSI / Poverlac- Hipotekami / MORTGAGEE	TEB SH A	810532988	///			KolateralID: K70804 dt.18.05.2023	24.05.2023
BORXHLIU / Duznik / DEBTOR	"Hib Petrol" Sh.p.k	70249534	FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ /		MAGJ. FERIZAJ - PRISHTINË	KolateralID: K70804 dt.18.05.2023	24.05.2023



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPSTINA PEC



Kopje Plani - Kopija Plana




P/R 1: 2000

Zona Kadastrale: PETJE
Kadastarska Zona:

Plani Kadast. Nr.: _____
Kadast. Plan Br.: _____

POSEDUESI: _____ "H113 PETROL" SH. P. K.
POSEDNIK: _____
BASHKËPOSEDUES NË PJESË IDEALE: _____
SUPOSEDNIKË U IDEALNE DELOVIMA: _____



Nr. rendor i registrit të taksave: _____
Red. broj spiska katastarskih taksa: _____

Nr. 1 lēndēsi: _____
Br. predmeti: _____

[illegible]

Kopja e planit është besnikë e origjinalit të votë sipas gjendjes së fundit në Katastrin e Kadastrit të Shkupit. Da je ova kopja verda svoime originalu prema poslednjem stanju u Katastru.

Punol: _____
 Uradio-la: _____
 Pejē: 25.02 20 25 vit.
 Peč: _____ god.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG
PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY**

Komuna: Pejë
Zyre: Zyra kadastrale komunale

Numri referent i lëndës: 0043531-19

Në mbështetje të Nenit 3 të Ligjit Nr. 2002/5 mbi Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, Ligjit Nr. 2003/13 dhe neni 4 i Ligjit Nr. 04/L-009, në bazë të kërkesës së HIB PETROL SH.P.K, me numër biznesi 70249534., nxjerr këtë:

AKTVENDIM

APROVOHET – Kërkesa e parashtruar nga HIB PETROL SH.P.K, me numër biznesi 70249534., e cila ka të bëjë me Bartja e qiramarrjes të qiramarrësi i ri, sipas aktit juridik Kontratë për Bartjen e të drejtës së qirambajtjes për 99-Vite,nr.rend.471/2019,ref.1725/2019,të dt.14.02.2019,e vërtetuar te Noteri.Bashkim Stavileci në njësinë/t kadastrale: Paluajtshmëria ka qenë e regjistruar në emër të:
"Ndërmarrja e Re Fabrika e Baterive Industriale Trepça"SH.P.K. qirambajtjes për 99 vite me numër biznesi 70952203

Numri kadastrale	Zona Kadastrale	Vendi i quajtur	Sipërfaqja e gjithmbarshme	Të dhënat për gjendjen e re të krijuar
P-71611071-04687-5	PEJË	ZENELAGINO POLE	5272	„Hib Petrol" Sh.p.k. me numër biznesi 70249534 <i>pe 99 vite akt</i>

Arsyetim

Zyra Kadastrale Komunale Pejë ka pranuar kërkesën e parashtruar nga HIB PETROL SH.P.K, me numër biznesi 70249534., për regjistrimin e të drejtave në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme dhe kërkesës së tij-saj ia ka bashkangjitur dëshmitë e plota për regjistrim (lloji i dokumentit): Kontratë për Bartjen e të drejtës së qirambajtjes për 99-Vite,nr.rend.471/2019,ref.1725/2019,të dt.14.02.2019,e vërtetuar te Noteri.Bashkim Stavileci,Çertifikata e pronësisë ,kopja e planit,letërnjoftimet kopje.

Sipas gjendjes së konstatuar janë plotësuar të gjitha kushtet për regjistrim sipas dispozitave të cekura më lart.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur ka të drejtë që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi të kërkoj nga ZKK rishqyrtimin e tij.

Aktvendimi i dorëzohet:
Arkivit,
Shërbimit përkatës,
Parashtruesit të kërkesës

Zyrtari përgjegjës
Ajtene Ternava

Data: 15.04.2019



Drejtori
Mustafë Nila



Kopje e Çertifikuar

NOTER "BASHKIM STAVILECI" – PEJË



KONTRATË PËR BARTJEN E TË DREJTËS SË QIRAMBAJTJES **(me bartje te mëvonshme të pronësisë)**

Nr. Rend 471/2019

Nr. Ref. 172/2019





BASHKIM STAVILECI
PEJË

Kopje e Çertifikuar

Numri Rendor 471/2019

Numri i Referencës 172/2019



KONTRATË PËR BARTJEN E TË DREJTËS SË QIRAMBAJTJES

(me bartje te mëvonshme të pronësisë)

Sot, më katërmbëdhjetë shkurt dy mijë e nëntëmbëdhjetë, para meje Bashkim Stavileci, Noter me seli në Pejë, rr. Mbretëresha Teutë nr. 122 – Qendra Semitronix nr. 2-p, me kërkesë për redaktimin noterial të vullnetit të tyre, njëkohësisht janë paraqitur:-----

1. "Ndërmarrja e Re Fabrika e Baterive Industriale Trepça" Sh.p.k. me seli në rr. VII. Gërvalla-Pejë me numër të biznesit 70952203, e cila është në pronësi të shoqërisë tregtare "A.E. Distribution" Sh.p.k, me seli në adresën rruga Presidenti George W. Bush KPP, Kulla 3, H-1, Kati II, Tiranë – Republika e Shqipërisë, me numër të biznesit K21915002R, dhe zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë të cilin e përfaqëson me prokurë të posaçme nga **Z. Xhelal Radoniqi**, i lindur më 22.09.1954 në Pejë, bartës i letërnjoftimit me nr. Personal 1003705524, sipas autorizimit të përpiluar dhe vërtetuar nga Notere Manushaqe Jaupi në Tiranë, me nr.6278 Rep. dhe nr. 1589 Kol. nga datë 27.12.2017 (në tekstin e mëtejme: **Shitësi**)-----

2. "Hib Petrol" Sh.p.k. shoqëri e themeluar dhe që vepron sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, me seli në Magjistralen Ferizaj - Prishtinë, me nr. të regjistrimit të biznesit **70249534**, e përfaqësuar nga perfaqesuesi ligjor **Z. Astrit Topalli**, i lindur në Greme me 07.11.1990, shtetas i R. se Kosovës, identitetin e te cilit e konstatova në bazë të letërnjoftimit me nr. ID0327574 të lëshuar më 11.06.2015 dhe me nr. personal 1177697296, sipas autorizimit të përpiluar dhe vërtetuar nga Noter Selatin D. Shahini me seli në Ferizaj, LRP Nr. 1237/2019 të datës 29.01.2019 (në tekstin e mëtejme: **Blerësi**)-----

Ekspoze.-----

Mënyra e Fitimit – Palët kontraktuese të lartë cekura një zërit deklarojnë së prona me të dhënat e identifikuar në lëndën e kësaj kontrate fillimisht është fituar përmes Marrëveshjes per Shitblerjen e Aksioneve te Thjeshta ne Ndërmarrjen e re Fabrika e Baterive Industriale Trepça Shpk të lidhur në mes të Agjencisë së Kosovës për Privatizim (në tekstin e mëtejme: AKP) dhe Aksionarit te Shitësit "A. E Distribution" Shpk me numër të protokollit 1082, nr. i Fq. 225, e datës 14.06.2013, pjesë përbërëse e së cilës është Deklarata në lidhje me bartjen e Aseteve dhe Detyrimeve të Përcaktuara, ku përfshihet edhe paluajtshmëria objekt i kësaj Kontrate, nga e cila

një kopje do t'i bashkëngjitet kësaj kontrate si Aneks, respektivisht ndodhet në arkivin e noterit.

Përderisa Shitësi ka prezantuar raportin e Auditimit të Plotësimit të Kushteve të Kontratës nr. 1082, dhe prezanton dhe merr përsipër të sjellë Vendimin e Bordit Drejtorëve të AKP-së për lirim nga obligimet Kontraktore dhe përfundimin e monitorimit, pasi që te ketë pranuar atë nga AKP-ja.

Shitësi gjithashtu konfirmon dhe garanton se "Ndërmarrja e Re Fabrika e Baterive Industriale Trepça" Sh.p.k. ka përmbushur të gjitha kushtet e privatizimit dhe se nuk ka asnjë pengesë në lidhje me disponimin e aseteve të saj, duke përfshirë transferimin e të drejtave në asete (duke përfshirë edhe objektin e kësaj kontrate) tek palët e treta, dhe se nuk ka asnjë obligim të papërmbushur të saj në raport me AKP-në i cili mund të krijojë ndonjë të drejtë të AKP-së në raport me paluajtshmërinë/objektin e kësaj Kontrate.

Pasi u binda në vullnetin e plotë të palëve dhe pasi konstatova se ato posedojnë zotësi juridike për të vepruar në këtë punë juridike, palët deklaruan si vijon:

I.OBJEKTI I SHITJES

Me shiqimin e Certifikatës pronësore me nr. të lëndës 11361 të datës 28.01.2019 të lëshuar nga ZKK Pejë, të cilin palët e prezantuan në origjinal, konstatova se objekt i bartjes së të drejtës për qirambajtje me bartje të mëvonshme të pronësisë është patundshmëria e cila gjendet në ZK Pejë, ngastra kadastrale nr. **P-71611071-04687-5**, vendi i quajtur Zenelagino Pole, me sipërfaqe prej **5272m²**.


Në rubrikën poseduesi-pronari është i shënuar bartësi i të drejtës së qirambajtjes për 99 vite - "Ndërmarrja e Re Fabrika e Baterive Industriale Trepça" Sh.p.k., me pjesën e pronës 1/1, ndërsa në rubrikën e ngarkesave nuk ka të shënuar asnjë ngarkesë apo kufizim pronësor.

Noteri iu tërhoqi vërejtjen palëve në mundësinë që në ndërkohë ka mund të ndryshojë gjendja kadastrale për atë paluajtshmëri apo në mundësinë e mos harmonizimit të ekstraktit të prezantuar kadastral me evidencat kadastrale, mirëpo palët marrin për bazë deklarin dhe garancionin nën betim të shitësit se nuk ka asnjë ndryshim në mes të ekstraktit kadastral me evidencën kadastrale të paraqitur.

II. SHITJA

Shitësi e bartë të drejtën e qirambajtjes ndërsa Blerësi e blen të drejtën e qirambajtjes për paluajtshmërinë e përshkruar në pikën I. të kësaj kontrate me pjesën e pronës 1/1.

Shitësi transferon te Blerësi të gjitha të drejtat dhe titujt që i ka Shitësi mbi paluajtshmërinë e përshkruar në pikën I. të kësaj Kontrate, si dhe çdo përfitim e të drejtë të fituar apo e cila duhet t'i transferohet Blerësit pas skadimit të afatit të qiradhënies për 99 vite.



Blerësi i pranon të drejtat dhe titujt që i ka Shitësi mbi paluajtshmërinë që është objekt i kësaj kontrate në gjendjen "siç është" dhe në kushtet siç ishin në kohën e transferimit. -----

-----III.ÇMIMI-----

Çmimi i patundshmërisë nga pika I. të kësaj kontrate është **950.000,00€ (nëntëqind e pesëdhjetë mijë euro)**.-----

-----III/a Mënyra e pagesës-----

Pagesa do të realizohet, përmes transferit bankar nga llogaria e Blerësit në llogarinë e Shitësit, pagesa do të realizohet në tre këste:-----

kësti i parë në shumë prej **300,000.00€** do të realizohet më së largu gjerë me datën **01/03/2019**,-----

kësti i dytë në shumë prej **300,000.00€** do të realizohet më së largu gjerë me datën **15/03/2019** si dhe, -----

kësti i tretë në shumë prej **350,000.00€** do të realizohet më së largu gjerë me datën **31.03/2019**.-----

Pas pagesës së plotë të çmimit kontraktues, palët kontraktuese obligohen të prezantojnë dëshmitë bankare për kryerjen e transaksionit, me çka do të konfirmojnë edhe përfundimin e obligimeve reciproke. Çmimi i paguar nga Blerësi tek Shitësi i përcaktuar me këtë Nen është shuma e vetme të cilën Blerësi i detyrohet Shitësit në lidhje me objektin e kësaj Kontrate, dhe përfshinë edhe transferimin e plotë të pronësisë tek Blerësi në ngastrën në fjalë me rastin e plotësimit të kushteve ligjore për transferimin dhe regjistrimin e pronësisë së Blerësit. Shitësi nuk ka të drejtë të kërkojë asnjë shumë shtesë për kalimin nga e drejta e Qirambajtjes në Pronësi të plotë të Blerësit.-----

-----IV. PËRGJEGJËSIA PËR TË METAT MATERIALE E JURIDIKE-----

Shitësi nuk garanton për të metat e dukshme dhe të padukshme materiale të cilat mund t'i ketë paluajtshmëria e përshkruar më lartë. Shitësi deklaron se nuk i është e njohur asnjë e metë e fshehur. Blerësi është mirë i njohur me gjendjen faktike të paluajtshmërisë dhe e blen të drejtën e qirambajtjes mbi paluajtshmërinë në gjendjen faktike dhe juridike çfarë është sot.-----

Shitësi garanton se paluajtshmëria e cekur nuk është e ngarkuar me ndonjë të drejtë apo kufizim dhe se nuk është e ngarkuar me ndonjë kërkesë të siguruar me hipotekë, kamatë, tatime apo kontribute.-----

Po ashtu, shitësi garanton se është posedues i vetëm i paluajtshmërisë, se paluajtshmëria nuk është në kontest gjyqësor dhe se shitësi për këtë paluajtshmëri nuk ka lidhur ndonjë kontratë tjetër.-----

Shitësi nuk është në dijeni për ndonjë ndalesë për mundësinë e ndërtimit në ngastrën e cekur, mirëpo Blerësi deklaron se i merr mbi vete të gjitha përgjegjësitë dhe rreziqet lidhur me

3

mundësinë e ndërtimit në atë ngastër.-----

-----**V. GARANCITË DHE PËRFAQËSIMET SPECIALE TË SHITËSIT**-----

Shitësi garanton se i njëjti ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në raport me AKP-në në kapacitetin e tij si privatizues i paluajtshmërisë e cila është objekt i kësaj Kontrate e të cilat detyrime rrjedhin nga Kontrata e Shitblerjes me numër 1082 dhe nr.Fq. 225, e datës 14.06.2013 dhe Marrëveshjes për Zotime, e lidhur ndërmjet Shitësit dhe AKP-së dhe se nuk ka asnjë kufizim në kapacitetin juridik të Shitësit për të lidhur dhe ekzekutuar këtë Kontratë në lidhje me objektin e saj.-----

Shitësi garanton se ka përmbushur të gjitha kushtet nga privatizimi i paluajtshmërisë objekt i kësaj Kontrate, sikurse janë të përcaktuara në Marrëveshjen për Zotime, dhe se nuk ka pranuar asnjë vërejtje për shkelje në përmbushjen e zotimit dhe se nuk ka ndonjë kusht të pa plotësuar apo të plotësuar pjesërisht, e për shkak të të cilave AKP ka të drejtën e ushtrimit të ndonjë të drejte në raport me paluajtshmërinë objekt i kësaj Kontrate, apo në raport me aksionet e Shitësit si ish ndërmarrje shoqërore.-----

Shitësi i garanton dhe deklaron Blerësit se pas kalimit të afatit prej 99 viteve të qirambajtjes së paluajtshmërisë objekt të kësaj kontrate, Shitësi do të njohë bartjen e titullit dhe të drejtave pronësore Blerësit në bazë të kësaj Kontrate dhe se për këtë i jepë autorizimin tani përmes kësaj Kontrate dhe se Shitësi nuk do të kërkojë të ushtrojë çfarëdo të drejte në lidhje me paluajtshmërinë objekt i kësaj Kontrate, përfshirë por pa u kufizuar në, kërkimin e kthimit të pronës -----

Shitësi garanton dhe përfaqëson tek Blerësi se "Ndërmarrja e Re Fabrika e Baterive Industriale Trepça" Sh.p.k. ka përmbushur të gjitha kushtet e privatizimit dhe se nuk ka asnjë pengesë në lidhje me disponimin e aseteve të saj, duke përfshirë transferimin e të drejtave në asete (duke përfshirë edhe objektin e kësaj kontrate) tek palët e treta, dhe se nuk ka asnjë obligim të papërmbushur të saj në raport me AKP-në i cili mund të krijojë ndonjë të drejtë të AKP-së në raport me objektin e kësaj Kontrate.

Shitësi Garanton dhe përfaqëson se nuk ka asnjë palë të tretë e cila ka pretendim pronësor apo pasuror në raport me objektin e kësaj Kontrate, duke përfshirë edhe organet publike (Administrata Tatimore e Kosovës dhe të ngjashme), dhe se nuk kanë asnjë njohuri dhe informacion të mundësisë së një kërkesë të tillë nga çfarëdo pale e tretë bazuar në veprimtarinë dhe veprimet juridike të shitësit.

Shitësit garanton dhe i zotohet Blerësit se do të mbajnë Blerësin e padëmtuar ndaj çdo veprimi, shpenzimeve, procedurave, dëmeve dhe fitimit të humbur nga kërkesat direkt ose indirekt të marra kundër Blerësit, të shkaktuara ose të pësura nga Blerësi që lindin (direkt ose indirekt) në lidhje me përfaqësimet dhe garancionet e Shitësit të dhëna në këtë Kontratë ose çfarëdo kërkesë në lidhje me të metat juridike të objektit të kësaj Kontrate. Shitësi zotohet dhe

garanton se do ta zhdëmtoj Blerësin në lidhje me të gjitha kërkesat e tilla sipas kërkesave dhe dëshmive të Blerësit. -----

-----**VI. KALIMI I POSEDIMIT, DOBIVE, BARRAVE E RREZIQEVE**-----

Posedimi, dobitë, barrat dhe rreziqet kalojnë në Blerësin në momentin e pagesës së tërësishme të çmimit të kontraktuar.-----

-----**VII. SHPENZIMET, TATIMET**-----

Pasi Noteri iu bëri me dije se për shpërblimin dhe shpenzimet e Noterit përgjigjet Blerësi nëse nuk janë marrë vesh ndryshe, palët dakordohen që të gjitha shpenzimet lidhur me këtë kontratë, shpenzimet e taksave për pëlqimet eventuale të organeve kompetente dhe deklaratave, si dhe shpenzimet për regjistrimin e të drejtës së pronësisë i bartë Blerësi.-----

-----**VIII. PËLQIMET, E DREJTA E PARABLERJES**-----

Duke hulumtuar të gjitha mundësitë Noteri ju komunikoi palëve se kjo kontratë nuk i nënshtrohet kërimit të ndonjë pëlqimi dhe se në rastin konkret nuk ekziston e drejta ligjore e parablerjes së paluajtshmërisë të ndonjë pale të tretë.-----


-----**IX. KËRKESAT PËR REGJISTRIM DHE AUTORIZIMET TJERA TË SHITËSIT PËR BLERËSIN**-----

Shitësi e jep pëlqimin që blerësi të regjistrohet në Kadastër si bartës i vetëm i të drejtës për qirambajtje për 99 vite të paluajtshmërisë nga pika I. të kësaj kontrate pasi të realizohet në tërësi çmimi kontraktues. Blerësi autorizohet të bëjë regjistrimin e tillë në kadastër pa praninë e Shitësit dhe pa pëlqimin e tij të veçantë.-----

Shitësi përmes kësaj Kontrate Autorizon Blerësin që pa praninë e tij dhe pa pëlqimin e tij të veçantë, në cilëndo kohë patundshmërinë e cila është objekt i kësaj kontrate, ta lenë në hipotekë apo ta ngarkojë me çfarëdo barre tjetër në dobi të blerësit. -----

Shitësi përmes kësaj Kontrate gjithashtu Autorizon Blerësin që pa praninë e tij dhe pa pëlqimin e tij të veçantë, në cilëndo kohë që i mundësohet nga legjislacioni në fuqi në Kosovë, të bëjë regjistrimin e pronësisë së plotë në ngastrën e cila është objekt i kësaj kontrate nga e drejta e Qirambajtjes e cila është aktualisht. Regjistrimi i pronësisë së Blerësit konsiderohet se është pjesë e detyrimeve integrale të Shitësit si pjesë e kësaj Kontrate dhe kundër-vlerë e pagesës së çmimit Kontraktues.-----

Autorizimi i Shitësit për Blerësin që pa praninë e tij dhe pa pëlqimin e tij të veçantë, në cilëndo kohë që i mundësohet nga legjislacioni në fuqi në Kosovë, të bëjë regjistrimin e drejtës së



Qirambajtjes afatgjate dhe me vonë transferimin e pronësisë së plotë në ngastrën e cila është objekt i kësaj kontrate, është i pakufizuar në kohë dhe i parevokueshëm.-----

-----X. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE-----

Noteri iu tërhoqi vërejtjen palëve: se blerësi e fiton të drejtën e pronësisë vetëm **pas pagesës së plotë të çmimit të shit-blerjes**, përkatësisht pas regjistrimit të bartjes së pronësisë në kadastrin e paluajtshmërive dhe se kjo kontratë mund t'i nënshtrohet pagesës së tatimit për bartjen e paluajtshmëve, nëse është e paraparë me dispozita ligjore.-----

-Kopjet e vërtetuara të këtij akti noterial i dorëzohen:-----

--Shitësit(1),-----



--Blerësit(1),-----

--Zyrës kadastrale përmes Blerësit(1)-----


Tarifa noteriale për përpilimin e aktit noterial është caktuar në bazë të nenit 21. pika 1. të Udhëzimit Administrativ nr. 2/2012, në shumë prej 980,00 € (nëntëqind e tetëdhjetë euro) + TVSH në vlerë prej 18%, të cilën është i obliguar ta paguaj shfrytëzuesi i shërbimeve noteriale.--


Pasi që palëve ju lexua Kontrata mbi bartjen e të drejtës për qirambajtje, ato deklaruan se e kanë kuptuar përmbajtjen e kësaj pune juridike dhe se janë të pajtimit me këtë akt, të cilin e miratojnë me vullnetin e tyre, çka e dëshmojnë me vënien e nënshkrimeve, të cilin pas tyre e nënshkruan edhe Noteri.-----

Përpiluar në Zyrën noteriale në Pejë më **14.02.2019**. -----

Shitësi, Përfaqësuesi i autorizuar,



Blerësi, Përfaqësuesi i autorizuar,




Noteri,



NXERRJA E KOPJES NGA ORIGJINALI

Bazuar në Ligjin e Noterisë Nr.03-L/2010 datë 06.11.2008, neni 3 pika 3.1. origjinali i aktit ruhet tek noteri ndërsa palëve u lëshohen ekstrakte të vërtetuara nga origjinali (neni 57 pika 1). Noteri vërteton se ekstraktet e lëshuara për palë, kadastër dhe për organet tjera kompetente janë plotësisht identike me origjinalin.

Pejë, më katërmëdhjetë shkurt dymijë e nëntëmbëdhjetë.





TÜRKİYE İŞ BANKASI A.Ş. DEGA Nİ KOSOVO
Nr. Biznesit: 70899345
Rr. UÇK Nr.43
Prishtina, Kosova
Tel: 038 245245

Dega - Branch:

URDHËR TRANSFER NACIONAL - NATIONAL TRANSFER ORDER

Të dhënat mbi Urdhëruesin / Ordering Customer Details

Nr. i llogarisë / Account No.:

2 1 4 8 0 3 1 4 5 5 6 0 0 2 6 3

Emri / Name:

HIB PETROL SHPK

Adresa / Address:

FERIZAJ

Ref.:

Tel.

049780023

Të dhënat mbi Përfutuesin / Beneficiary Details

Nr. i llogarisë / Account No.:

1 7 0 6 0 0 1 0 1 2 3 5 0 8 4 3

Emri / Name:

NDERMARRJA E RE FBI TREPÇA PEJE

Adresa / Address:

PEJE

Banka e Përfutuesit / Beneficiary's Bank:

NLB BANK

Të dhënat mbi pagesën / Payment Details:

PAGESE PER PATUNDSHMERI NGA STRA KADASTRALE P-71611071-04687-5

NUMRI I REFERENCES 172/2018 FATURA 010/2019 NGA HIB PETROL

Shuma e transferit / Transfer Amount

Valuta / Currency

E U R

Shuma / Amount

300,000.00

In words/Me fjallë

TRE ZERO ZERO ZERO ZERO ZERO

Tafirat / Charges

Tarifë e Bankës / Bank Charge

(EUR) min

Vlera-Amount

Të dhënat statistike - Rregulla XI e BPK-së - E ndryshuar me/...../2005 - Statistical Data - BPK Rule XI - Amended of/...../2005

Të dhënat për shënimin e pagesës për 10,000.00 Euro ose më shumë, sipas kësaj shume në valutë (që - Please complete this form for payments of 10,000.00 Euros or more, as required in order currency)

Dërgohet e transaktimit - merrë në veshje të ndërtat transaktimit të ndërtat për shuma të ndërtat - If necessary, split amount - If a payment is intended for several separate transactions split amount

Transaktimi / Transactor

Kodi i Transaktimit Transaction Code	Pershkrimi i Transaktimit / Description of the transaction	Shuma / Amount (Te mbushet nese shuma eshte ndares / Fill out, if amount is split)
2 4 6	OTHER BUSINESS ACTIVITIES	300,000.00

Të dhënat shpreh në lidhje me llogaritë e transaktimit - Informata mbi natyrën e transaktimit, duke përfshirë shumat e ndërtat

TÜRKİYE İŞ BANKASI A.Ş.

Vafa / Stamp

21-02-2019

Data / Date 21-Feb-19

Emri i klijentit dhe data / Bank signature, total and date

Emri i klijentit dhe data / Signature

Deklarata e Klientit / Customer Declaration

Unë/Ne e vërtetojmë se të dhënat e klijentit janë të saktë dhe të vërteta. Unë/Ne deklarojmë se nuk kemi marrë parasysh asnjë informacion të shtesë që mund të ndryshojë kësaj deklaratë.

I/We declare that the information given is true and correct. I/We declare that we have not taken into account any additional information that may change this declaration.

Je e deklaram se të dhënat e klijentit janë të saktë dhe të vërteta. Unë/Ne deklarojmë se nuk kemi marrë parasysh asnjë informacion të shtesë që mund të ndryshojë kësaj deklaratë.

I/We declare that the information given is true and correct. I/We declare that we have not taken into account any additional information that may change this declaration.

Ordering Customer will accept full responsibility for the return of funds due to the lack of information from the client. I/We declare that, at extra cost that may bear any connection with money transfer I/We will compensate.

Turkiye İş Bankası A.Ş. Dega në Prishtinë, Kosovë nuk është përgjegjëse për kthimin e parave për shkak të mungesës së informacionit nga klijenti. I/We declare that, at extra cost that may bear any connection with money transfer I/We will compensate.

Turkish Is Bank and U.S. Dept. of Justice will not be responsible for the return of funds due to the lack of information from the client. I/We declare that, at extra cost that may bear in connection with money transfer, I/we will compensate



TÜRKİYE İŞ BANKASI A.Ş. DEGA NÉ KOSOVO
Nr. Biznesit: 70899345
Rr. UÇK Nr.43
Prishtina, Kosova
Tel: 038 245245

Dega - Branch:

URDIHËR TRANSFER NACIONAL - NATIONAL TRANSFER ORDER

Te dhënat mbi Urdhëruesin / Ordering Customer Details

Nr. i llogarisë / Account No.:

2 1 4 8 0 3 1 4 5 5 6 0 0 2 6 3

Emri / Name: HIB PETROL SHPK

Adresa / Address: FERIZAJ

Ref.:

Tel. 049780023

Te dhënat mbi Përfutuesin / Beneficiary Details

Nr. i llogarisë / Account No.:

1 7 0 6 0 0 1 0 1 2 3 5 0 8 4 3

Emri / Name: NDERMARRJA E RE FBI TREPÇA PEJE

Adresa / Address: PEJE

Banka e Përfutuesit / Beneficiary's Bank: NLB BANK

Te dhënat mbi pagesën / Payment Details:

PAGESE PER PATUNDSHMERI NGA STRA KADASTRALE P-71611071-04687-5

NUMRI I REFERENCES 172/2018 KESTI I TRETE

Informatat mbi urdheruesin / Ordering customer information

Nr. i DI ose Regjistrimit te Firmes / ID or Registration No:

Resident ☒ Jo-Resident ☐

Kodi i Shtetit / Country Code: K S

Shuma e transferit / Transfer Amount

Valuta / Currency: E U R Shuma / Amount: 350,000.00

In words/ Në fjale: TRE PESE ZERO ZERO ZERO ZERO

Tarifat / Charges

Tarifa e Bankes / Bank Charge (EUR) mva Vlera-Amount

Te dhënat statistikore - Rregulla XI e BPK-se - E ndryshuar me/...../2005 - Statistical Data - BPK Rule XI - Amended of/...../2005

Lehet te plotësohet formën për pagesat 10,000 EUR e më shumë, sipas shprehjes në vlerat tjera. Për të plotësuar këtë formë të pagesave të 10,000 EUR ose më shumë, të shprehjes në vlerat tjera. Detajet e transaksionit, nëse është e nevojshme të shprehë në vlerat tjera, të shprehës për secilin pagesë të ndërtuar. Nëse është e nevojshme, shprehë në vlerat tjera të shprehës për secilin pagesë të ndërtuar.

Transaksi / Transactor		Shuma / Amount
Kodi i Transaksionit / Transaction Code		(Te mbushet nese shuma eshte ndaras / Fill out, if amount is split)
2 4 6	OTHER BUSINESS ACTIVITIES	350,000.00

Te shprehë shifra në lidhje me llogarë të ndërtuar të transaksionit, përfshirë shumën (nëse është e mundur)

TÜRKİYE İŞ BANKASI A.Ş.

Vite / Stamp

29-03-2019

Data / Date: 29-Mar-19

Deklarim i Klientit / Customer Declaration

Unë/Ne e urdhërojmë Türkiye İş Bankası A.Ş. Dega në Prishtinë/Kosovë të transferojë këtë shuma sipas të dhënave të mësipërme të dhëna dhe të jetë e mundur të shprehë në vlerat tjera. Unë/Ne do të respektojmë rregullat dhe kushtet e përdorimit të Bankës së Turqisë në Prishtinë/Kosovë.

Kurdi thirrjen e përdorimit të shprehës në vlerat tjera.

Nëse është e mundur të shprehë në vlerat tjera, Türkiye İş Bankası A.Ş. Dega në Prishtinë/Kosovë do të transferojë këtë shuma sipas të dhënave të mësipërme të dhëna dhe të jetë e mundur të shprehë në vlerat tjera.

Unë/Ne e urdhërojmë Türkiye İş Bankası A.Ş. Dega në Prishtinë/Kosovë të transferojë këtë shuma sipas të dhënave të mësipërme të dhëna dhe të jetë e mundur të shprehë në vlerat tjera.

Ordering Customer will apply national law regarding

Türkiye İş Bankası A.Ş. Dega në Prishtinë/Kosovë will not be responsible for the return of funds due to the lack of information from the client. User declares that, at extra cost that may incur in connection with money transfer, they will compensate.

Dega Prishtinë / Kosova





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA SERVICES
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA /
KOSOVOCADASTRAL AGENCY

Më Kërkesën e Z. Xhelal Radoniqi nga Peja i autorizuar, nga Subjekti .Ndërmarrja e Re Fabrika e Bateria Industriale "Trepça" Sh.p.k, lidhur me lëshuarjën e vertetimit për ndarjën e Parcelës me nr. 4687/1 Z.k Pejë , ZKK-a në Pejë lëshon këtë:

V E R T E T I M

Më të cilin VERTETOHET së Paluajtshmëria nga Parcela kadastrale me nr. 4687/1 me sip. prej 14.313 m2 kulturës Fabrikë dhe 11.75.59 m2 kulturës oborrë i fabrikës, së bashku me Parcelën nr. 4674/2 me sip. prej 3250 m2 kulturës arë Z.K Pejë , në pronësi të Ndërmarrja e Re Fabrika e Bateria Industriale "Trepça" në Pejë, sipas evidencës kadastrale nga Regjistri i ndryshimeve RDPP-së 908/2017 janë ndarë në bazë të Kërkesës me nr. 01-5-1/588P datës 11.12.2017 si dhe Kërkesës me nr. 01-5-1/5989 dt. 21.12.2017, dhe pas ndarjës së këtyre Parcelave janë formuar Parcela të reja dhe atë:

Parcela me nr. 4687/3	me sip. prej 14.313 m2 kulturës shtëpi.
_____/____	4687/3 me sip. prej 105.992 m2 kulturës oborr.
_____/____	4687/4 me sip. prej 7522 m2 ____/____ arë2.
_____/____	4687/5 me sip. prej 5272 m2 ____/____ arë2.
_____/____	4687/6 me sip. prej 1615 m2 ____/____ arë2.
_____/____	4687/7 me sip. prej 408 m2 ____/____ arë2.

Vertetimi parashtruesit të kërkesës i lëshohet me kërkesën e tij dhe i njëjti i shërben për nevoja personale.


Pejë, dt. 28.08.2018

Shefi i Shërb.Juridik,


Musa Haxhiu



Drejtori,


Mustafë Nila



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government



Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrasnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Agjencia e Menaxhimit Emergjent/Agencija Emergentnog Upravljanja
Emergency Management Agency

Agjencia e Menaxhimit Emergjent, Departamenti i Parandalimit, në mbështetje të Nenit 12 dhe 13 të Ligjit për mbrojtje nga zjarri 04/L-012 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/ 10 gushtë 2011) , Nenin 44, 50 dhe 86. LPA, nr. 05/L-031, Drejtori i Departamenti i Parandalimit duke vendosur sipas kërkesës nr.283/2020, lëshon këtë:

P Ë L Q I M

“HIB PETROL” Sh.P.K nga Ferizaj i lëshohet pëlqimi në dokumentacionin teknik mbi masat e parapara për mbrojtje nga zjarri për piken për furnizim me derivateve të naftës ,me kapacitet të rezervuarve v= 1x 50761, 1x 62485, 1x 50.761 dhe 1x 20.204 litra naftë dhe benzinë, si dhe ai i GLN-së 20.000 litra, kjo pikë e derivateve gjenet në kuadër të parcelës kadastrave nr. 04687-5, certifikata e pronës- njësis kadastrale P-71611071-04687-5,” , Zona kadastrale Peja Komuna e Perjës. Investitori është i obliguar që gjatë ndërtimit dhe funksionalizimit të këtij objekti të ndërmerr të gjitha masat e parapara nga aspekti i mbrojtjes nga zjarri sipas rregullave teknike në bazë të akteve ligjore.

A r s y e t i m

“HIB PETROL” Sh.P.K nga Ferizaj I ka parashtruar kërkesa në Agjencinë e menaxhimit Emergjent për dhënien e pëeqimit në dokumentacionin teknik mbi masat e parapara për piken për furnizim me derivateve të naftës ,me kapacitet të rezervuarve v= 1x 50761, 1x 62485, 1x 50.761 dhe 1x 20.204 litra naftë dhe benzinë, si dhe ai i GLN-së 20.000 litra, kjo pikë e derivateve gjenet në kuadër të parcelës kadastrave nr. 04687-5, certifikata e pronës- njësis kadastrale P-71611071-04687-5,” , Zona kadastrale Peja Komuna e Perjës.Kërkesës pala i ka bashkangjitur: certifikata e biznesit, certifikatën e njësisë kadastrave, kopjen e kontratës, pëlqimin në lokacion nr. 178/2016, projektin-elaboratin e mbrojtjes nga zjarri dhe pagesat e taksave .

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shikimit të dokumenteve, nga ana e komisionit është konstatuar se në dokumentacionin teknik janë përfshirë masat thelbësore për mbrojtje nga zjarri, investitori është i obliguar që gjatë ndërtimit dhe funksionalizimit të objektit të aplikoj të gjitha masat mbrojtëse nga zjarri sipas akteve ligjore në fuqi, andaj komisioni ka propozuar për lëshimin e këtij pëlqimi.

Nr. 229/20

Prishtinë, 28.07.2020



Drejtori i Departamenti i Parandalimit



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING	
Nr. Org. Org. Jedinica Org. Unit	02-Sp.
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	4552-2/16
Nr. f. pagave Broj, stranica No pages	- 04 -
Date Datum Date	08.12.2016
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	25.11.2016
REFERENC-Ë:	16/4552/1- 713/DMM
PËR/ZA/TO:	"Ndërmarrja e Re Fabrika e Baterive Industriale Trepça " Sh.p.k. Pejë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 16/4552/1- 713/DMM dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për pëlqim mjedisor për Stacionin e Karburanteve në Pejë.
2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,

Faqe 1 nga 4

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary

Në bazë të nenit 29.paragrafi 1, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, nenit 22 dhe nenit 25 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214 dhe nenit 90. të LPA (Nr.02/L-28), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e Kompanisë “Ndërmarrja e Re Fabrika e Baterive Industriale Trepça “ Sh.p.k. Pejë për pëlqim mjedisor për Stacionin e Karburanteve në Pejë.

Mënyra e operimit është e përshkruar në vijim (Arsyetim) dhe është e obligueshme për palën.

A r s y e t i m

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka shqyrtuar kërkesën, Raportin e VNM-së dhe dokumentacionin e dorëzuar të kompanisë “Ndërmarrja e Re Fabrika e Baterive Industriale Trepça “ Sh.p.k. Pejë për pëlqim mjedisor për Stacionin e Karburanteve, në ngastrën kadastrale P- 71611071-04687-1, nr. i lëndës së Çertikatës, 01-1056-16 Zona kadastrale Pejë , komuna e Pejës.

Në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-214 për VNM , neni 20 , është mbajtur debati publik, dhe me këtë rast, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i **jep pëlqimi mjedisor**, për ndërtimin e stacionit të karburanteve për rezervarët me kapacitet 2x50761 litra për naftë dhe 1x62485 litra, 1x20204 litra për benzinë si dhe rezervarit me kapacitet prej 20 m³ për gaz (propan- butan), nën kushtet si vijon:

- Të ndërtohet sistemi për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave sipërfaqësore, nga të gjitha sipërfaqet funksionale dhe ujërave të zeza (separatori për vajra dhe gropa septike) adekuate me standarde dhe konform ligjit.

Faqe 2 nga 4

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave “ Rilindja ” kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



- Të vendoset sistemi i gypave për ftohjen me anë të ujit në rezervuarin me lëndë djegëse të gazta për pengimin e ndikimit direkt, të nxehtësisë gjatë sezonës së verës.
- Të betonohet dhe izohet platoja ku do të vendosen rezervarët e derivateve.
- Të betonohet dhe izohet platoja e sipërfaqeve operacionale.
- Të bëhet vendosja e kontejnerëve të posaçëm për deponimin e mbeturinave të ngurta në mënyrë që ambienti rreth lokalitetit të jetë çdo herë i pastër.
- Rregullisht të pastrohet seperatori dhe gropa septike.
- Të bëhet monitorimi i ujit para shkarkimit të tij.
- Të bëhet mbjellja me druj dekorativ dhe barishte e sipërfaqeve të pa betonuara.
- Të përgatitet dhe implementohet plani akcional për raste aksidenti.
- Aplikuesi përpos kushteve të lartë cekura t'i përmbahet rekomandimeve dhe kushteve të përshkruara në raportin e VNM-së.

Nëse nuk respektohen kushtet e lartcekura, pëlqimi do të merret (anulohet).

Pëlqimi Mjedisor është kusht për marrjen e Lejes Ndërtimore.

Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj dhe të pajiset me Leje Mjedisore

Ky Pëlqim Mjedisor vlen për dy vite konform nenit 25 të Ligjit për VNM Nr. 03/L-214.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë në afat 30 ditësh nga dita e pranimin të të njëjtit.


Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 16/4552/1 - ZSP/223/16 datë: 25.11.2016

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Kabinetit të Ministrit
5. Arkivit të MMPH-së

Arben ÇITAKU

 Sekretar i Përgjithshëm

2. SHTOJÇË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Neni 31.

Leja Mjedisore

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithësesi para lëshimit në punë.

Neni 35.

Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rreziqshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.





REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPESINOR MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING	
Nr. Org. Org. Jedinica Org. Unit	SP-02
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	4317-2/18
Nr. fazeve Broj stranic No. pages	03
Data Datum Date	02.08.18
Prishtine / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përhershëm / Kancelarija Stalno Sekretara / Office of the Permanent Secretary

DATË/A:	01.08.2018
REFERENC-Ë:	18/4317/1-515/DMMU
PËR/ZA/TO:	„Hib Petrol“ Sh.p.k. Talinoc i Muhaxherëve, Ferizaj
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e ka shqyrtuar kërkesën e Juaj, dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përhershëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the Permanent Secretary

Në bazë të nenit 29.paragrafi 1, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, nenit 22 dhe nenit 25 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214 dhe nenit 44. të LPA (Nr.05/L-031), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e Kompanisë „Hib Petrol“ Sh.p.k. Talinoc i Muhaxherëve, Ferizaj, për transferim të Pëlqimit Mjedisor për Stacionin e Karburanteve, në Pejë .

A r s y e t i m

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), ka shqyrtuar kërkesën dokumentacionin e dorëzuar të kompanisë „Hib Petrol“ Sh.p.k. Talinoc i Muhaxherëve, Ferizaj, për transferim të Pëlqimit Mjedisor të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për kompaninë “Ndërmarrja e Re Fabrika e Baterive Industriale Trepça “ Sh.p.k. Pejë, me Vendim të datë: 25.11.2016 dhe nr.prot.: 16/4552/1- ZSP/ 223 /16, për Stacionin e Karburanteve, në ngastrën kadastrale P- 71611071-04687-1, nr. i lëndës së Çertikatës, 01-1056-16 Zona kadastrale Pejë , komuna e Pejës.

Në bazë të Neni 8. të Ligjit Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e miraton kërkesën për transferim

Faqe 2 nga 3

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave “ Rilindja” kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



të pëlqimit mjedisor, me Vendim të datë: 25.11.2016 dhe nr.prot.: 16/4552/1- ZSP/ 223 /16, nga kompania "Ndërmarrja e Re Fabrika e Baterive Industriale Trepça " Sh.p.k. Pejë, në kompaninë „Hib Petrol“ Sh.p.k., Talinovc i Muhaxherëve Ferizaj si trashëguese e ardhshme e këtij Pëlqimi Mjedisor për Stacionin e Karburanteve, në ngastrën kadastrale P- 71611071-04687-1, nr. i lëndës së Çertifikatës, 01-1056-16 Zona kadastrale Pejë, komuna e Pejës.

Kompania trashëguese „Hib Petrol“ Sh.p.k. Talinovc i Muhaxherëve, Ferizaj, është e obliguar që tu përmbahet rekomandimeve në Raportin për VNM dhe ti përmbushë të gjitha kushtet e paraqitura në Pëlqimin Mjedisor.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr. 18/4317/1 -ZSP- 228/18 datë:01.08.2018

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Kabinetit të Ministrit
5. Arkivit të MMPH-së

Arben ÇITAKU

Sekretar i Përgjithshëm